



VENDIM

Nr.45 Datë 28.05.2009

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURAVË PËR MODIFIKIMIN E LICENSËS SË
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË
“FAVINA” 1 SH.P.K ME SERI PV05V, NR.29, LËSHUAR ME
VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.85,
DATË 27.12.2005**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 10, pika “3” dhe nenit 15 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plote /te pjesshem dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, dhe nenit 18 pika 1, germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin nr.21, datë 18.03.2009, të Bordit të Komisionerëve, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës __.05.2009, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Fvina 1” sh.p.k., për ndryshimin e liçensës Nr.29, Seria PV05P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.85, datë 27.12.2005 dhe informacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe konstatoi paraqitjen e plotë të dokumentacionit sic kërkohet nga “Rregullorja për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /te pjesshem dhe rinovimit të liçensave”

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për ndryshimin e liçensës Nr.29, Seria PV05P, të shoqërisë “Favina 1” sh.p.k, për kryerjen e aktivitetit prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.85, datë 27.12.2005.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari I ERE-s

Bujar Nepravishta

Ne mungese dhe me porosi Ardian Haci